

VENDIM
Nr.564, datë 7.5.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.857, DATË 20.12.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR FINANCIMIN E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
PARËSOR NGA SKEMA E DETYRUESHME E SIGURIMEVE TË KUJDESIT
SHËNDETËSOR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4, pika 2, shkronja “b”, dhe 36 të ligjit nr.7870, datë 13.4.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 124 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fjalja e dytë e pikës 7 të vendimit nr.857, datë 20.12.2006 të Këshillit të Ministrave ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Të ardhurat e krijuara nga shërbimet e ofruara, sipas kësaj pike, përdoren për bashkëfinancimin e kostos së mirëmbajtjes së qendrave shëndetësore. Rregullat e veçanta për përdorimin e tyre përcaktohen me udhëzim të Këshillit Administrativ të Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.”.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha